

KAMPIM DHE QËNDRIM NË NATYRË

Verë e diell, kampim dhe pjekje në skarë. Një zjarr kërcunjesh në errësirë të natës ose një shtrat prushi për gatim të ushqimit. Është kënaqësi me zjarr të kontrolluar. Por nëse zjarri nuk është i kontrolluar, kjo është pra zjarrndezje. Si mund të evitohet kjo?



QËNDRIM NË NATYRË

Njerëzve me përvojë qëndrimi në natyrë u pëlqejnë të ndezin zjarre jashtë, të tjerëve u pëlqen të marrin me vete një furnelë me lëndë djegëse me strehë ndaj erës për tu mbrojtur nëse koha keqësohet. Ata që i kalojnë pushimet verore në furgon ose barkë kanë në të shumtën e rasteve furnelë gazoli. Më poshtë ty të jepem disa udhëzime se si duhet ti shmangësh nëse has vështërsi.

ZJARR I HAPUR

Pikësëpari është me rëndësi të gjehet një vend i mirë për të ndezur zjarr. Shpeshherë gjenden vatra në arqipelagun dhe gjatë shtigjeve të shetitjeve.

Nëse nuk ka të tilla ty të duhet të zgjedhësh një vend të qetë dhe të mbrojtur, sa ma afër ujit sa të jetë e mundur. Ndërto vatrën me rërë dhe gurë. Mos ndez zjarr direkt mbi faqen e shkëmbit.

Nëse fryn erë ka rrezik për përhapje të xixave. Kujdesohu që asnjë xixë të mos fryn në drejtim të sterës ose pyllit. Në rast prognoze të rrezikut të zjarrit 5, është në fuqi ndalimi i ndezjes së zjarrit. Shuaj zjarrin para se ta lëshosh vendin.

FURNELË ALKOOLI

Gjenden tretësira të pandotura të mjedisit që nuk pluhurosin ose që nuk i jepin ushqimit shije të keqe. Mbushe pipthin e kandilit të aparatit për djegie me 2/3 e lartësisë. Mos e mbush kandilin para se të fiket dhe ftohet krejtësisht.

GAZOL

Gazoli duhet të trajtohet me respekt Plasaritja mund të shkaktojë

eksplozion dhe zjarr. Pajisja e re që ka hy në përdorim pas 1995 duhet ta ketë shenjën – CE. Mendo në ventilacionin nëse përdor pajisje gazoli në shtëpizë, barkë dhe furgon. Për të paralajmëruar në rast të një plasaritjeje të mundshme është shtuar një lëndë kundërmuese në gazol, merkaptan. Mbylle pajisjen dhe ajros menjëherë kur ti ndjen ndonjë fare pak erën e keqe. Plasaritja mund të lokalizohet me ndihmën e "sprejrit të plasaritjes" Kujdesohu që plasaritja të jetë kompakte dhe kontrollo me saktësi vendin e plasaritjes.

Më shumë njohuri për gazol mund të merren në broshurën e Shoqatës Suedeze të gazit (Svenska Gasföreningens skrift) "Mendo më parë - ndez pastaj: gazol në shtëpi, furgon, autobus shtëpiak dhe barkë dëfrimi (Tänk först – tänd sedan: gasol i stuga, husvagn, husbil och fritidsbåt). Informime ka edhe në dispozitat e Entit për mbrojtje nga zjarri dhe këshilla të përgjithshme për gazol në furgon (Räddningsverkets föreskrifter om allmänna råd om gasol i husvagn).

ALARMUES ZJARRI

Një alarmues zjarri është një siguri i lirë i jetesës edhe në furgon dhe barkë. Ai reagon në atë tymin e rrezikshëm për jetën dhe të paralajmëron ty.

ZJARRFIKËSE DORE

Për kampim, furgon ose barkë rekomandojmë një zjarrfikëse pluhuri me sèpaku 3 kg. Zjarrfikësja duhet të jetë e vërtetuar nga SIS ose nga ndonjë organ tjetër dëshmues të akredituar nga SWEDAK. Si një minimum ne rekomandojmë klasë A 13 dhe klasë B 113, por gjithmonë është më mirë me një zjarrfikëse me efektivitet të nivelit më të lartë.

NËSE MERR ZJARR TELEFONO GJITHMONË 112

Shoqata Suedeze për mbrojtje nga zjarri është një organizatë anëtarësie që punon për një Suedi më të sigurt nga zjarri. Nëpërmjet të informimit dhe shkollimit ne ndihmojmë njerëz, ndërmarrje dhe organizata që ta mbajnë vetë përgjegjësinë e tyre nga zjarri. **Telefoni 08 – 588 474 oo. svbf.se**